

**PROJEKTI BINJAKËZIMIT I BE
“MBËSHTETJE PËR STATISTIKAT”
KOSOVË**

BINJAKËZIM: **SHKËMBIMI I EKSPERTIZËS** **DHE INFORMACIONIT**

Projektet e binjakëzimit përbëjnë një iniciativë të Bashkimit Evropian, që ka për qëllim të ndihmojë vendet e reja anëtare, vendet kandidate ose vendet fqinje të fitojnë shkathhtësi dhe përvojat e nevojshme për përvetësimin, zbatimin dhe fuqizimin e legjisllacionit të BE-së. Varësisht nga nevoja, projektet bëjnë bashkë ekspertizën e sektorit publik nga vendet anëtare të BE-së dhe vendet partnere me qëllim rritjen e aktiviteteve bashkëpunuese midis tyre. Projektet e Binjakëzimit janë projekte të përbashkëta të të dy administratave partnere, që ndahen pas një thirrjeje për propozime. Në këtë projekt binjakëzimi, Agjencia e Statistikave të Kosovës bashkëpunon me Statistikat e Danimarkës. Ekspertë nga vende të ndryshme anëtare të BE-së gjithashtu janë të përfshirë në projekt.

PROJEKTI I **BINJAKËZIMIT I BE NË** **FUSHËN E STATISTIKAVE**

Agjencia e Statistikave të Kosovës në partneritet me Statistikat e Danimarkës ka filluar realizimin e projektit të Binjakëzimit, që do të zgjasë 24 muaj. Synimi i përgjithshëm i projektit është të fuqizojë sistemin statistikor në Kosovë, me fokus në përmirësimin e Llogarive Kombëtare dhe Statistikave të Biznesit në përputhje me standardet e BE-së, dhe modernizimin e sistemeve të TI-së dhe diseminimit përmes internetit.

Qëllimet e projektit të **Binjakëzimit janë:**

- Zhvillimi i kapaciteteve të ASK-së dhe përkrahja e ASK-së në realizimin e aktiviteteve bazë të saj në një formë të standardizuar

- Përmirësimi i cilësisë së Llogarive Kombëtare dhe fillimi i prodhimit të llogarive në baza tremujore
- Përmirësimi i Statistikave Strukturore të Bizneseve dhe rritja e mbulueshmërisë së statistikave afat shkurta
- Përforcimi i sistemit të TI-së në ASK dhe diseminimit të statistikave përmes internetit

METODAT E **PUNËS**

Rezultatet e projektit do të realizohen duke aplikuar dialogun si metodë pune midis partnerëve të barabartë.

Transferimi i njohurive, duke përfshirë përvajtjen me rregulloret e BE-së në fushën e statistikave, do të realizohet përmes seminareve dhe takimeve të punës, që do të mbahen në Kosovë, gjatë projektit. Në kuadër të secilit komponent do të organizohen vizita zyrtare në vendet anëtare të BE-së me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe informimit rreth praktikave më të mira në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, do të ketë trajnime praktike lidhur me çështje si nxjerrja e mostrës, imputimet dhe sigurimi i cilësisë.

FUSHAT DHE **REZULTATET E PRITURA**

Projekti i Binjakëzimit është i organizuar në katër komponente. Rezultatet e pritura të projektit të Binjakëzimit janë të specifikuara për secilin komponent veç e veç.

KOMPONENTI 1: **NJË SISTEM CILËSIE** **PËR STATISTIKAT**

Aktivitetet në komponentin 1 – Një Sistem Cilësie për Statistikat është dizajnuar për të

fuqizuar kapacitetin e përgjithshëm të ASK-së dhe përkrahur ASK-në në realizimin e aktiviteteve në një formë të standardizuar. Aktivitetet në këtë komponent do të rezultojnë me:

- Azhurnimin e planit statistikor të punës
- Përgatitjen e politikave dhe udhërrëfyesve për zbatimin e sistemit të cilësisë

KOMPONENTI 2: **LLOGARITË KOMBËTARE**

Aktivitetet në komponentin 2 do të rrisin përputhshmërinë me standardin aktual të BE-së, ESA 2010. Pritet të realizohen këto aktivitete:

- Rishikimi i Llogarive Kombëtare dhe analizimi i burimeve të të dhënave, në dispozicion
- Rishikimi i prodhimit të llogarive në baza vjetore me qasjen e prodhimit dhe shpenzimeve dhe me çmime konstante dhe aktuale, sipas ESA 2010;
- Zbatimi i rekomandimeve relevante të Planit të Veprimtë për përpilimin dhe publikimin e statistikave gjithëpërfshirëse mbi Llogaritë Kombëtare dhe tregun e punës dhe rishikimi i Llogarive Kombëtare vjetore bazuar në burime të reja dhe metodologjinë e përmirësuar

KOMPONENTI 3: **STATISTIKAT E BIZNESIT**

Aktivitetet në komponentin 3 do të përmirësojnë Statistikat Strukturore të Bizneseve, do të rrisin mbulueshmërinë e statistikave

afatshkurta dhe përmirësojnë Regjistrin Statistikor të Bizneseve.

Në kuadër të këtij komponenti priten këto rezultate:

- Përmirësimi i Statistikave Strukturore të Bizneseve, përfshirë mbledhjen, përpunimin e të dhënave, afatet kohore dhe mbulueshmërinë
- Përgatitja e indikatorëve të rinj afat shkurtër, përfshirë indeksin e prodhimit industrial dhe çmimet e prodhimit.
- Përgatitja e statistikave afat shkurta të caktuara, sipas NACE Rev. 2
- Përmirësimet e Regjistrit Statistikor të Bizneseve

KOMPONENTI 4: **TI DHE DISEMINIMI**

Aktivitetet në komponentin 4 janë dizajnuar për të përmirësuar sistemet e TI-së dhe cilësinë e shërbimeve të TI-së për ASK-në. Por, komunikimi përmes internetit, aktivitetet që lidhen me shtypin, mediat dhe marketingun e shërbimeve statistikore gjithashtu do të përfshihen në këtë komponent.

Rezultatet e pritura në këtë komponent janë:

- Fuqizimi i sistemit të TI-së
- Përmirësimi i diseminimit të statistikave përmes internetit
- Sigurimi i specifikimeve për një rrjet të brendshëm (Intranet)
- Përmirësimi i faqes së internetit të ASK-së dhe përdorimit të saj
- Instalimi i bazës së të dhënave për diseminimin dhe në dispozicion për publikun

FINANCIMI

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian në kuadër të Programit IPA 2012 – KS 12 IB ST 01 me një shumë prej 1,500,000 EUR.

MENAXHMENTI I PROJEKTIT DHE INFORMACIONE KONTAKTI

ILIR T. BERISHA

UDHËHEQËS I PROJEKTIT TE BINJAKËZIMIT NË KOSOVË
Drejtor, Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
Agjencia e Statistikave të Kosovës
E-mail: **llir.t.berisha@rks-gov.net**

LARS THYGESEN

UDHËHEQËS I PROJEKTIT TË BINJAKËZIMIT
nga Vendet Anëtare
Drejtor
Statistikat e Danimarkës
E-mail: **lth@dst.dk**

TEUTA ZYBERI

HOMOLOGE E KËSHILLTARIT REZIDENT TE BINJAKËZIMIT
Zyrtare e Lartë për Marrëdhënie me Jashtë
Agjencia e Statistikave të Kosovës
E-mail: **teuta.zyberi@rks-gov.net**

PER KNUDSEN

KËSHILLTAR REZIDENT I BINJAKËZIMIT (RTA)
Shef Divizioni
Statistikat e Danimarkës
Telefoni: +386 (0)49819307
E-mail: **pkn@dst.dk**

NORA ZOGAJ

ASISTENTE e RTA
Telefoni: +377 (0)44248199
E-mail: **nzogaj@yahoo.com**